

Nr. Prot. 039/B/21**Nr. i Regjistrimit: 51****RREGULLORE****PËR****"ZBATIMIN E POLITIKËS SË PËRDORIMIT TË DREJTË DHE
METODOLOGJINË E VLERËSIMIT TË QËNDRUESHMËRISË SË HEQJES
SË TARIFAVE TË ROAMINGUT ME PAKICË PËR MARRËVESHJEN E
ROAMINGUT ME BALLKANIN PËRENDIMOR"****Neni 1****Baza Ligjore**

Kjo rregullore është nxjerrë në bazë të nenit 1, nenit 3, paragrafi 1), nenit 9 paragrafi 1), neni 64 paragrafi 1) dhe nenit 79, paragrafët 1) dhe 2), të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (tutje referuar si - Ligji); Nenit 1, 2, 3, 4, 5, dhe nenit 7 të Marrëveshjes për zvoglimin e çmimeve të shërbimeve të roamingut për rrjetet publike të komunikimeve elektronike mobile në regjionin e Ballkanit Përendimor" (Ref. Nr.Prot. 249/2/19 - tutje referuar Marrëveshja e Roamingut) të nënshkruar ndërmjet Ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike nga: Republika e Shqipërisë, Republika e Bosnie dhe Hercegovinës, Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë Veriore, Republika e Malit të Zi dhe Republika e Serbisë (tutje referuar si - Ballkani Përendimor ose BP) më datë 04 Prill 2019; Rregulloren implementuese të Komisionit (BE) nr. 2016/2286, e cila rregullon politikën e përdorimit të drejtë.

KAPITULLI I**Dispozitat e Përgjithshme****Neni 2****Qëllimi dhe fushëveprimi**

- 2.1 Kjo Rregullore përcakton kriteret të hollësishme për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të një politike të përdorimit të drejtë që ofruhet e shërbimit të roamingut mund të aplikojnë për konsumin e shërbimeve të rregulluara të roamingut të ofruara në nivel të çmimeve kombëtare me pakicë.
- 2.2 Rregullorja gjithashtu përcakton kriteret dhe procedurat lidhur me:

- a) kërkesat e ofruesve të roamingut për autorizim nga ARKEP, për të aplikuar një tarifë shtesë të roamingut, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e modelit të tyre të tarifimit të brendshëm (nivel kombëtar);
- b) metodologjinë që do të zbatohet nga ARKEP për të vlerësuar nëse ofruesi i roamingut ka dhënë prova se nuk është në gjendje të mbulojë kostot e saj për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut, pasi që kjo do të dëmtoj qëndrueshmërinë e modelit të saj të tarifimit në nivel të brendshëm/kombëtar.

Neni 3 Përkufizimet

3.1 Për qëllime të kësaj rregulloreje:

3.1.1 Kuptimi ose përkufizimi i secilës fjalë, frazë apo shprehje sipas Ligjit do të jetë i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë rregullore.

3.1.2 Shprehjet dhe frazat në vijim do të kenë këtë kuptim;

- a) **ARKEP** - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- b) **Çmimi i brendshëm me pakicë** - është çmimi i njësisë me pakicë të ofruesit të roamingut që zbatohet për thirrjet dalëse dhe mesazhet SMS të dërguara, të filluara dhe përfunduara në rrjete të ndryshme të komunikimit publik në Kosovë, ose për transferimin e të dhënave të konsumuara nga përdoruesi. Kur nuk ka një çmim specifik të brendshëm të shitjes me pakicë, i njëjti mekanizëm i faturimit supozohet si ai që aplikohet te përdoruesi për thirrjet dalëse dhe mesazhet e dërguara SMS, të filluar dhe të përfunduar në rrjete të ndryshme të komunikimit publik në Kosovë.
- c) **Operator** - Ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile;
- d) **Margjina e shërbimeve mobile** - nënkupton fitimet, përpara amortizimit dhe amortizimit të taksës së interesit, nga shitja e shërbimeve mobile përveç shërbimeve të roamingut me pakicë të ofruara brenda BP, duke përjashtuar kështu kostot dhe të ardhurat nga shërbimet e roamingut me pakicë;
- e) **Paketë e hapur e të dhënave (Open data bundle)** - nënkupton një plan tarifor për një ose më shumë shërbime mobile me pakicë që nuk kufizon volumnin e shërbimeve mobile me pakicë të të dhënave të përfshira kundrejtë pagesës së një tarife fikse periodike, ose për të cilat çmimi i brendshëm i njësisë së shërbimeve të shitjes me pakicë të të dhënave mobile, i përfshirë nga pjesëtimi i çmimit të përgjithshëm të brendshëm të shitjes me pakicë, duke përjashtuar TVSH-në, për shërbimet mobile që

korrespondojnë me të gjithë periudhën e faturimit me vëllimin e përgjithshëm të shërbimeve të shitjes me pakicë të të dhënave të disponueshme në vend, është më i ulët se tarifa e rregulluar maksimale e roamingut referuar në Vendimin e ARKEP për implementimin e marrëveshjes së roamingut;

- f) **Plani tarifor me parapagim** - nënkupton një plan tarifor nën të cilin shërbime të telefonisë mobile me pakicë të ofrohuar përmes zbritjes së kredisë të vënë në dispozicion nga klienti për ofruesin e shërbimeve mbi baza për njësi, para konsumit, dhe nga i cili një klient mund të tërhiqet pa gjorbë me shpenzimin ose skadimin e kredisë.
- g) **SMS i rregulluar në roaming** - do të thotë një SMS i dërguar nga një përdorues roaming që fillon në një rrjet të vizituar dhe përfundon në një rrjet publik të komunikimit në rajonin e BP ose një SMS i marrë nga një përdorues roaming që fillon në një rrjet publik të komunikimit në BP dhe përfundon në rrjetin e vizituar.
- h) **Shërbime mobile me pakicë** - nënkupton shërbimet publike të komunikimeve mobile të ofruara për përdoruesit fundorë, duke përfshirë zërin, SMS dhe shërbimet e të dhënave (Internetin);
- i) **Shërbim i rregulluar i të dhënave në roaming** - do të thotë një shërbim që mundëson përdorimin e të dhënave me kalim të paketave nga një përdorues roaming përmes pajisjes së tij mobile përderisa është i lidhur me një rrjet të vizituar në rajonin e BP.
- j) **Thirrje e rregulluar e roamingut** - do të thotë një thirrje telefonike me zë në dalje e kryer nga një përdorues roaming që fillon në një rrjet të vizituar dhe përfundon në një rrjet të komunikimit publik në vendet e BP ose një thirrje telefonike me zë hyrëse të marrë nga një parapagues i roamingut dhe fillon në një rrjet publik të komunikimit në rajonin e BP dhe përfundon në një rrjet të vizituar.

KAPITULLI II

Politika e Përdorimit të Drejtë

Neni 4

Parimet Bazike

- 4.1 Obligohen operatorët e telefonisë mobile në Republikën e Kosovës që të ofrojnë shërbimet me pakicë të rregulluara të Roamingut sipas çmimit të aplikuar në nivel kombëtar për parapaguesit e tij, të cilët zakonisht janë rezidentë ose kanë lidhje të qëndrueshme në

Kosovë dhe që sjellin një prani të shpeshtë dhe të konsiderueshme, përderisa ata udhëtojnë periodikisht në vendet e BP.

- 4.2 Çdo politikë e përdorimit të drejtë e zbatuar nga një ofrues i shërbimit të Roamingut në mënyrë që të parandalojë përdorimin abuziv ose jo normal të shërbimeve me pakicë të rregulluara të Roamingut, duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore dhe Rregulloret e miratuara nga ARKEP për Kontratat me Parapaguesit, si dhe duhet të sigurojnë që të gjithë parapaguesit e Roamingut të kenë qasje në shërbimet e rregulluara të Roamingut me çmim të nivelit kombëtar, gjatë udhëtimeve të tilla periodike në vendet e BP, në të njëjtat kushte sikur shërbimet e tilla të konsumoheshin brenda vendit (Republikën e Kosovës).

Neni 5

Politika e Përdorimit të Drejtë

- 5.1 Për qëllim të zbatimit të politikës së përdorimit të drejtë, ofruesi i shërbimit të Roamingut, mund të kërkojë nga parapaguesit e tij që të siguroj prova të posedimit të lejes së qëndrimit në Republikën e Kosovës ose lidhjeve të tjera të qëndrueshme me Kosovën, duke sjellë një prani të shpeshtë dhe thelbësore në territorin e saj.
- 5.2 Pa paragjykuar çdo zbatim të kufizimit të vëllimit të lejuar në nivel kombëtar, në rastin e një pakete të hapur të dhënash, përdoruesi i Roamingut kur udhëton në mënyrë periodike në njërin nga vendet e BP, duhet të jetë në gjendje të konsumojë një vëllim të të dhënave të shërbimit roaming me pakicë sipas çmimit të brendshëm me pakicë të aplikuar në Republikën e Kosovës, që është ekuivalent me të paktën dyfishin e sasisë/vëllimit, e cila rezulton duke pjesëtuar çmimin e përgjithshëm të brendshëm me pakicë të ajo pako e të dhënave të hapura (pa përfshirë TVSH-në), që korrespondon me të gjithë periudhën e faturimit nga tarifa e rregulluar maksimale e Roamingut me shumicë, të miratuar nga ARKEP.
- 5.3 Në rast të shitjes në pako (bundle) të shërbimeve mobile me pakicë me shërbime të tjera ose pajisje terminale, çmimi i përgjithshëm i brendshëm me pakicë i një pako e të dhënave do të përcaktohet, duke marrë parasysh çmimin e aplikuar në shitjen e veçantë të përbërësit të shërbimeve mobile me pakicë të paketës (pa TVSH) ose çmimi për shitjen e shërbimeve të tilla me të njëjtat karakteristika mbi një bazë të pavarur.
- 5.4 Në rastin e planeve tarifore me parapagim (pre-paid), si një alternativë ndaj kërkesës së politikës së përdorimit të drejtë të specifikuar në paragrafin 1) të këtij neni, Ofruesi i shërbimit të roamingut mund të kufizojë konsumin e shërbimeve të shitjes me pakicë të të dhënave brenda BP me çmimin e brendshëm me pakicë në vëllimin, i cili është ekuivalent me të paktën vëllimin, i cili fitohet duke pjesëtuar shumën e përgjithshme (pa TVSH) të pjesës së mbetur nga kredia e disponueshme dhe ajo e paguar tashmë nga parapaguesi tek ofruesi i shërbimit, në momentin e fillimit të roamingut, me tarifën

maksimale të rregulluar të roamingut në nivel me shumicë, të referuar në Vendimet e ARKEP për implementimin e marrveshjes së roamingut.

5.5 Në mënyrë që të parandalohet përdorimi abuziv ose jo normal i shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë të ofruara me çmimin e brendshëm me pakicë, ofruesi i roamingut mund të aplikojë mekanizma të drejta, të arsyeshme dhe proporcionale të kontrollit bazuar në tregues objektiv që lidhen me rrezikun e përdorimit abuziv ose jo normal përtej udhëtimeve periodike në vendet e BP.

5.5.1 Treguesit objektiv mund të përfshijnë masa për të përcaktuar nëse parapaguesit kanë konsum të brendshëm mbizotërues mbi konsumin në roaming ose praninë mbizotëruese të brendshme të parapaguesit ndaj pranisë në Shtetet e tjera të BP.

5.5.2 Në mënyrë që të sigurohet se parapaguesit, të cilët udhëtojnë në mënyrë periodike nuk i nënshtrohen alarmeve/njoftimeve të panevojshme ose të tepruara në përputhje me Nenin 6 të kësaj Rregulloreje, ofruesit e roamingut që zbatojnë masa të tilla për të përcaktuar rrezikun e përdorimit abuziv ose jo normal të shërbimeve të roamingut duhet të vëzhgojnë tregues të tillë të pranisë dhe konsumit në mënyrë kumulative dhe për një periudhë kohore prej të paktën katër (4) muaj.

5.5.3 Ofruesi i shërbimit të Roamingut duhet të specifikojë në kontratat me paraoaguesit se për cilin shërbim ose shërbime mobile me pakicë është i lidhur treguesi i konsumit, si dhe kohëzgjatjen e periudhës minimale të periudhës së monitorimit/vëzhgimit.

5.5.4 Si mbizotërimi i konsumit të brendshëm të parapaguesit ndaj konsumit në roaming, ashtu edhe prania mbizotëruese e parapaguesit në Kosovë se në roaming, gjatë periudhës së vëzhgimit duhet të konsiderohet si një provë e përdorimit jo abuziv dhe jo normal të shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë.

5.5.5 Për qëllim të zbatimit të paragrafëve 5.5.2) dhe 5.5.4), çdo ditë kur një parapagues roaming ka hyrë në rrjetin e brendshëm duhet të llogaritet si një ditë e pranisë së brendshme të atij konsumatori.

5.5.6 Tregues të tjerë objektivë të rrezikut të përdorimit abuziv ose jo normal të shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë të ofruara sipas çmimit të brendshëm me pakicë mund të përfshijë vetëm:

- a) pasiviteti i gjatë i një karte SIM, e cila lidhet me përdorimin kryesisht, nëse jo ekskluzivisht, gjatë roamingut;
- b) abonim dhe përdorim i njëpasnjëshëm i shumë kartave SIM nga i njëjti parapagues gjatë roamingut.

- 5.6 Aty ku Ofruesi i Roamingut e vërteton, me prova objektive dhe të mbështetura, se një numër kartash SIM kanë qenë objekt i rishitjes së organizuar për personat që nuk banojnë në mënyrë efektive ose kanë lidhje të qëndrueshme që sjellin shpesh dhe prania e konsiderueshme në Kosovë në mënyrë që të mundësohet konsumimi i shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë të ofruara duke aplikuar çmimin të brendshëm me pakicë përveç asaj për qëllime periodike udhëtimit, ofruesi i roaming-ut mund të marrë masa të menjëhershme proporcionale në mënyrë që të sigurojë pajtueshmëri me të gjithë kushtet e kontratës themelore.

Neni 6

Transparenca dhe Mbikëqyrja e Politikës së Përdorimit të Drejtë

- 6.1 Nëse një operator që ofron shërbime të rregulluara të roamingut zbaton një "politikë të përdorimit të drejtë", ai duhet të përfshijë në kontratat me parapaguesit roaming, të gjitha kushtet dhe afatet që lidhen me atë politikë, duke përfshirë të gjithë mekanizmat e kontrollit të zbatuar në përputhje me nenin 5 të kësaj Rregulloreje. Si pjesë e politikës së përdorimit të drejtë, ofruesi i roaming-ut obligohet që të vendosë procedura transparente, të thjeshta dhe efikase, për të adresuar ankesat e parapaguesve në lidhje me zbatimin e politikës së përdorimit të drejtë. Kjo nuk cenon të drejtat e parapaguesit/klientit në roaming, për të përfituar nga procedurat transparente, të thjeshta, të drejta dhe të menjëhershme jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në Kornizën Rregullatore. Një mekanizëm i tillë i ankesave dhe procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do t'i mundësojnë parapaguesit/konsumatorit të roaming të japë prova që nuk është duke i përdorur shërbimet e rregulluara të roaming me pakicë për qëllime të ndryshme nga udhëtimi periodik, për shkak të marrjes së një alarmi/njoftimi paralajmërues, në përputhje me këtë nen.
- 6.2 Në përputhje me këtë Rregullore, Operatorët obligohen që të njoftojnë ARKEP lidhur me Politikën e Përdorimit të Drejtë.
- 6.3 Në rastet kur ka prova objektive dhe të vërtetuara, bazuar në treguesit objektivë të referuar në nenin 5.5) të kësaj Rregulloreje, të cilat tregojnë për një rrezik të përdorimit abuziv ose jonormal të shërbimeve të rregulluara të roamingut në nivel me pakicë brenda vendeve të BP, ofruesi i roaming duhet të njoftojë parapaguesin për modelin e zbuluar të sjelljes që përbën një rrezik, përpara se të aplikoj ndonjë tarifë shtesë në përputhje me Vendimet e ARKEP.
- 6.3.1 Në rastet kur një rrezik i tillë rezulton nga mospërmbushja e dy kritereve, mbizotrimin të konsumit të brendshëm dhe pranisë së brendshme përgjatë periudhës së përcaktuar të vëzhgimit, referuar në nënparagrafin 5.5.2) të kësaj Rregulloreje, për qëllime të zgjidhjes së ndonjë ankese të mëvonshme ose për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, duhet të merren parasyshë

indikacione shtesë të rrezikut që rrjedhin nga prania e përgjithshme jashtë vendit ose përdorimi i parapaguesit roaming.

- 6.4 Kur të njoftohet parapaguesi në roaming në përputhje me paragrafin 6.3, ofruesi i roaming duhet ta informojë konsumatorin që, në mungesë të një ndryshimi në modelin e përdorimit brenda një periudhe që nuk mund të jetë më e shkurtër se 2 javë, duke demonstruar konsumin aktual ose praninë e brendshme, një tarifë shtesë në përputhje me Vendimin e ARKEP mund të aplikohet për çdo përdorim të mëtejshëm të shërbimeve të rregulluara të roamingut me kartën SIM në fjalë pas datës së specifikuar.
- 6.5 Ofruesi i roaming do të pushojë së zbatuari tarifën shtesë sapo përdorimi i parapaguesit nuk do të paraqis ndonjë rrezik të përdorimit abuziv ose jo normal të shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë bazuar në treguesit objektivë të referuar në paragrafin 5.5).
- 6.6 Kur një ofrues roaming vërteton që kartat SIM kanë qenë objekt i rishitjes së organizuar për personat që as nuk banojnë normalisht as nuk kanë lidhje të qëndrueshme që sjellin prani të shpeshtë dhe të konsiderueshme në Kosovë, ofruesi i roamingut me pakicë për të mundësuar konsumin e shërbimeve të rregulluara të roamingut, me përjashtim të qëllimit të udhëtime periodike jashtë vendit në përputhje me Nenin 4 (3), operatori duhet të njoftojë ARKEP me provat që karakterizojnë abuzimin sistematik në fjalë dhe masën e marrë për tu siguruar pajtueshmëria me të gjitha kushtet e kontratës themelore më së voni në të njëjtën kohë kur merret një masë e tillë.

KAPITULLI III

Zbatimi i Metodologjisë për vlerësimin e qëndrueshmësisë së heqjes së tarifave me pakicë të roamingut

Neni 7

Të dhënat e nevojshme për paraqitjen e aplikimit për zbatimin e tarifave shtesë të roamingut

- 7.1 Aplikimet për Autorizim të operatorëve që ofrojnë shërbime të rregulluara të roamingut për të zbatuar një tarifë shtesë në përputhje me Vendimin e ARKEP për implementimin e Marrëveshjes së Roamingut, për qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së modelit të saj të brendshëm të faturimit duhet të vlerësohen në bazë të një parashikimi të të dhënave në vëllimin e përgjithshëm i trafikut të shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë për një periudhë prej 12 muajsh, duke filluar jo më herët se nga data 01.07.2021 të dorëzuar nga operatori kërkues. Për aplikimin e parë, parashikimet e vëllimit të trafiku vlerësohen duke përdorur një ose një kombinim të disa prej opsioneve të mëposhtme:

- a) Vëllimet aktuale të trafikut të shërbimeve të rregulluara të roamingut të ofruara nga aplikuesi, për çmimet me pakicë të rregulluara të roamingut, të cilat janë zbatuar para datës 01 Korrik 2021;
 - b) vëllimet e parashikuara të shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë pas datës 01 Korrik 2021, ku vëllimet e parashikuara të rregulluara shërbimet e roamingut me pakicë gjatë periudhës në fjalë vlerësohen bazuar në konsumin aktual të brendshëm me pakicë të shërbimeve mobile dhe koha e kaluar jashtë Republikës së Kosovës në BP nga parapaguesit e operatorit kërkues/aplikantit;
 - c) Vëllimet e parashikuara të trafikut të shërbimeve të rregulluara të roamingut pas datës 01 Korrik 2021, ku vëllimi i trafikut të shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë vlerësohet në bazë të një ndryshimi proporcional në vëllimin e trafikut të shërbimeve të rregulluara të roamingut në planet tarifore të aplikantit, të cilat përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të bazës së përdoruesve, në të cilën çmimet e shërbimeve të rregulluara të shitjes me pakicë janë vendosur nga kërkuesi/aplikuesi në nivelin e brendshëm për një periudhë prej të paktën 30 ditësh, në një përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje.
- 7.2 Në rast se kërkesa azhurnohet, vëllimi i parashikuar i trafikut të shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë do të azhurnohet bazuar në modelin aktual të përdorimit mesatar të shërbimeve të brendshme mobile shumëzuar me numrin e përdoruesve të roamingut dhe kohën e kaluar në roaming në BP gjatë 12 muajve të mëparshëm.
- 7.3 Të gjitha të dhënat mbi kostot dhe të ardhurat e Aplikuesit duhet të bazohen në pasqyrat financiare, të cilat do t'i dorëzohen ARKEP-it, dhe këto të dhëna mund të azhurnohen sipas parashikimeve të vëllimit të trafikut në përputhje me paragrafin 7.1). Kur parashikohen kostot, devijimet nga shumat e marra nga pasqyrat e mëparshme financiare duhet të merren në konsideratë vetëm nëse ato vërtetohen me prova të angazhimeve financiare për periudhën e mbuluar nga parashikimet.
- 7.4 Aplikuesi duhet të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme të përdorura për të përcaktuar marginën e shërbimeve mobile dhe kostot totale aktuale dhe të projektuara të ofrimit të shërbimeve të rregulluara të roamingut dhe të ardhurat e gjeneruara nga sigurimi i këtyre shërbimeve në periudhën përkatëse.

Neni 8

Përcaktimi i kostove specifike të roamingut për ofrimin e shërbimeve me pakicë të rregulluara të roamingut

- 8.1 Në mënyrë që të përcaktohet që Aplikuesi nuk është në gjendje të mbulojë shpenzimet e kostove, të cilat mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e modelit të tij të faturimit të

brendshëm, vetëm kostot e mëposhtme të roamingut duhet të merren parasysh, nëse vërtetohen në kërkesën për autorizim për të aplikuar një tarifë shtesë të roamingut:

- a) Kostot për blerjen e qasjes me shumicë të roamingut;
 - b) Kostot specifike me pakicë të roamingut.
- 8.2 Sa u përket kostove të shkakëtuara për blerjen e shërbimeve të rregulluara të roamingut me shumicë, duhet të merret parasysh vetëm shuma me të cilën pagesat e përgjithshme të Aplikuesit për palët e tjera (operatorët e vendeve të BP) që ofrojnë këto shërbime në BP, pritet të tejkalojnë shumat e përgjithshme që i takojnë për ofrimin e të njëjtave shërbime për ofruesit e tjerë të roamingut në BP. Në rastin e shumave të paguara një operatori për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut, operatori që ofron shërbime roaming do të projektojë vëllimin e trafikut të këtyre shërbimeve me shumicë në roaming në përputhje me supozimin në të cilin bazohet vëllimi i parashikuar i trafikut në përputhje me paragrafin 1 të nenit 7.
- 8.3 Sa u përket kostove me pakicë që lidhen ekskluzivisht me roaming, vetëm kostot e mëposhtme duhet të merren parasysh, me kusht që ato të justifikohen në kërkesë:
- a) kostot e operimit dhe menaxhimit në lidhje me shërbimin roaming, përfshirë të gjitha sistemet të biznesit dhe softuerin e destinuar për sigurimin dhe menaxhimin e shërbimeve roaming;
 - b) kostot e barazimit (data clearing) të të dhënave dhe pagesave, përfshirë kostot e barazimit të të dhënave dhe barazimit financiar;
 - c) kostot e negocimit të kontratave dhe lidhjes së kontratave, përfshirë tarifatat e jashtme dhe përdorimin e burimeve të brendshme;
 - d) kostot e bëra për të qenë në përputhje me kërkesat për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut të përcaktuara në Vendimin e ARKEP për implementimin e marrëveshjes së roamingut, duke marrë parasysh "politikën e përdorimit të drejtë" të zbatuar nga operatori i roamingut.
- 8.4 Kostot e referuara në pikat a), b) dhe c) të paragrafit 8.3 duhet të merren parasysh vetëm në përpjesëtim me vëllimin e përgjithshëm të trafikut të shërbimeve të roamingut të rregulluara të Aplikuesit dhe trafikut të përgjithshëm me pakicë "outbound" dhe me shumicë "inbound" të shërbimeve të tij roaming, në përputhje me metodologjinë e dhënë në Shtojcën II, pikat 1 dhe 2 dhe në përpjesëtim me raportin e xhiros totale të shërbimeve të saj roaming me pakicë në BP dhe xhiros totale të shërbimeve të saj me pakicë në dhe jashtë BP, në përputhje me metodologjinë e dhënë në Shtojcën II, pikat 1 dhe 3.
- 8.5 Kostot e referuara në pikën d) të paragrafit 8.3 duhet të merren parasysh vetëm në përpjesëtim me raportin e vëllimit të përgjithshëm të trafikut të shërbimeve të roamingut

me pakicë të Aplikuesit në BP dhe trafikut të përgjithshëm të shërbimeve të tij të roamingut me pakicë brenda dhe jashtë BP, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Shtojcën II, pikat 1 dhe 3.

Neni 9

Alokimi i kostove për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut

- 9.1 Përveç kostove të përcaktuara në përputhje me Nenin 8, një pjesë e kostove të zakonshme (common costs) dhe të përbashkëta (joint costs) që shkakëtohen nga ofrimi i shërbimeve mobile me pakicë mund të përfshihen në aplikacionin për autorizim për të aplikuar një tarifë shtesë roaming. Vetëm kostot e mëposhtme duhet të merren parasysh, me kusht që ato të justifikohen në kërkesë:
- a) kostot e faturimit dhe mbledhjes, duke përfshirë të gjitha kostot që lidhen me përpunimin, llogaritjen, përgatitjen dhe dorëzimin e një fature specifike te përdoruesi;
 - b) kostot e shitjes dhe shpërndarjes, përfshirë kostot e operimit të dyqaneve dhe kanaleve të tjera të shpërndarjes për shitjen e shërbimeve mobile me pakicë;
 - c) kostot e kujdesit ndaj konsumatorit, përfshirë kostot operative të të gjitha shërbimeve të kujdesit ndaj konsumatorit në dispozicion të Parapaguesit;
 - d) kostot e administrimit të borxheve të këqija, përfshirë shpenzimet e bëra për të shkruar borxhet e pashlyera të konsumatorit he mbledhjen e borxheve të këqija;
 - e) kostot e marketingut, përfshirë të gjitha kostot e reklamimit të shërbimeve mobile.
- 9.2 Kostot e referuara në paragrafin 9.1) duhet të merren parasysh vetëm në përpjesëtim me raportin e trafikut të përgjithshëm të shërbimeve me pakicë të roamingut të Aplikuesit në BP, ndaj trafikut të përgjithshëm me pakicë të të gjitha shërbimeve mobile me pakicë, të marra si një mesatare e ponderuar e këtij raporti të shërbimit mobil, që pasqyrojnë çmimet mesatare të shitjes me shumicë të paguara nga Aplikuesi në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Shtojcën II, pikat 1 dhe 4.

Neni 10

Përcaktimi i të hyrave nga ofrimi i shërbimeve të rregulluara të roamingut

- 10.1 Në mënyrë që të përcaktohet që Aplikuesi nuk është në gjendje të rimbursojë kostot e tij, të cilat do të rrezikojnë modelin e tij të brendshëm të tarifimit, vetëm të ardhurat e mëposhtme duhet të merren parasysh dhe përfshihen në aplikimin për miratimin e tarifës shtesë të roamingut:

- a) të hyrat që rrjedhin drejtpërdrejt nga trafiku i shërbimeve mobile me pakicë, të origjinuara nga vendi i vizituar i BP;
- b) pjesa e të ardhurave të përgjithshme nga shitja e shërbimeve mobile me pakicë për tarifatat fikse periodike.

10.2 Të hyrat e referuara në pikën a) të paragrafit 10.1) duhet të përfshijnë:

- a) çdo tarifë me pakicë e mbledhur për trafikun që tejkalon çdo "politikë të përdorimit të drejtë" të zbatuar nga operatori i Roamingut;
- b) të gjitha të ardhurat nga ofertat alternative të roamingut, dmth. të ardhurat me pakicë nga shërbimet e roamingut në vendet e BP, të cilat janë të ndryshme nga shërbimet e rregulluara të roamingut me pakicë;
- c) të gjitha tarifatat e brendshme të shitjes me pakicë të llogaritura në bazë të një njësie të konsumit ose përdorimit pas konsumit të një tarife fikse periodike për ofrimin e shërbimeve mobile me pakicë të aktivizuara nga përdorimi i shërbimeve mobile me pakicë në vendin e vizituar të BP.

10.3 Për qëllimet e përcaktimit të të ardhurave të referuara në pikën b) të paragrafit 1, në rastin e shitjes së shërbimeve mobile me pakicë në një paketë me shërbime të tjera ose pajisje terminale, do të merren parasysh vetëm të ardhurat në lidhje me shitjen e shërbimeve mobile me pakicë. Të ardhurat e deklaruar do të përcaktohen në lidhje me çmimin e zbatueshëm për shitjen e veçantë të secilës përbërës të paketës, nëse është i disponueshëm, ose në lidhje me shitjen e pavarur të një shërbimi të tillë me të njëjtat karakteristika.

10.4 Për të përcaktuar pjesën e të hyrave të përgjithshme nga shitja e shërbimeve mobile me pakicë në lidhje me ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut me pakicë, duhet të zbatohet metodologjia e përcaktuar në Shtojcën II, pikat 1 dhe 5.

Neni 11

Vlerësimi i kërkesave të operatorëve për aplikimin e tarifave shtesë të roamingut për të siguruar qëndrueshmërinë e modelit të tyre të brendshëm

11.1 Kur vlerësohet një kërkesë nga një operator roaming për të dhënë një autorizim për aplikimin e një tarife shtesë roaming për të siguruar qëndrueshmërinë e modelit të saj të tarifimit të brendshëm, ARKEP mund të konstatojë se Aplikuesi nuk mund të rimbursojë kostot e ofrimit të shërbimeve të rregulluara të roamingut, të cilat do të mund të rrezikojë qëndrueshmërinë e modelit të saj të tarifimit të brendshëm, vetëm nëse margjina negative e roamingut neto me pakicë të Aplikuesit është të paktën 3% ose më shumë e margjinës të shërbimeve të tij mobile.

- 11.2 Margjina neto e roamingut me pakicë duhet të jetë shuma e mbetur pasi kostot e ofrimit të shërbimeve të rregulluara të roamingut janë zbritur nga të hyrat nga ofrimi i atyre shërbimeve, siç përcaktohet në përputhje me këtë Rregullore. Kur përcakton këtë shumë, ARKEP duhet të verifikoj të dhënat e paraqitura me kërkesë, në mënyrë që të sigurohet se është në pajtueshmëri me metodologjinë për përcaktimin e kostove dhe të të hyrave, siç përcaktohet në nenet 8, 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje.
- 11.3 Kur vlera absolute e marginës neto të roamingut me pakicë është 3% ose më shumë, e marginës së shërbimeve mobile, ARKEP do të refuzojë të japë pëlqimin për aplikimin e një tarife shtesë, nëse mund të vërtetohet se rrethanat e veçanta e bëjnë të pamundur që qëndrueshmëria e modelit të tarifimit të brendshëm të minohet. Rrethana të tilla përfshijnë situatat e mëposhtme:
- a) Aplikuesi është pjesë e një grupi dhe ka prova të transferimit të brendshëm të çmimit në favor të filialeve të tjerë të grupit, veçanërisht në lidhje me disbalancin e konsiderueshëm të tarifave të roamingut me shumicë të aplikuara brenda grupit;
 - b) Niveli i konkurrencës në tregjet e brendshme tregon se ekziston një kapacitet për të përballuar margjinat e reduktuara;
 - c) duke zbatuar një "politikë më të rreptë të përdorimit të drejtë", e cila mbetet në përputhje me nenet 4 dhe 5, margjina neto i roamingut me pakicë do të ulej në më pak se 3%.
- 11.4 Në rrethana të jashtëzakonshme kur operatori ka një diferencë negative të marginës së shërbimeve mobile dhe një margjinë neto negative të roamingut me pakicë, ARKEP do të miratojë aplikimin e një pagese shtesë për shërbimet e rregulluara të roamingut.
- 11.5 Kur miratohet tarifa shtesë për shërbimet e rregulluara të roamingut, ARKEP në vendimin përfundimtar përcakton shumën e marginës negative, për të cilën mund të sigurohet një rimbursim duke aplikuar një tarifë shtesë për shërbimet e roamingut të ofruara në BP. Tarifa shtesë duhet të jetë në përputhje me supozimet mbi trafikun roaming mbi të cilat bazohet vlerësimi i kërkesës dhe duhet të përcaktohet në përputhje me objektivat e përcaktuara në nenin 9 të Ligjit.

KAPITULLI IV

Monitorimi i zbatimit të Politikës së Përdorimit të drejtë dhe hyrja në fuqi

Neni 12

Monitorimi i zbatimit të Politikës së Përdorimit të drejtë

- 12.1 Me qëllim të monitorimit të zbatimit të kësaj Rregulloreje, ARKEP mund të kërkojë në mënyrë periodike informata nga operatorët.

Neni 13
Hyrja në fuqi

13.1 Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit me vendimin e Bordit të ARKEP.

13.2 Pjesë përbërse e kësaj rregulloreje janë edhe Shtojca I dhe Shtojca II.

Prishtinë, 22/06/2021

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Nazim Rahimi
Kryetar i Bordit

Ndryshimi proporcional në vëllimet aktuale të shërbimeve të rregulluara të roamingut nën regjimin “Roam-like-at-home” (RLAH), krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar:

$$\left(\frac{\sum_1^n Vëllimi_k(t)}{\sum_1^n Vëllimi_k(t-1)} - 1 \right) \times 100$$

ku:

“**k**” = shërbimi (1 = zëri, 2 = SMS, 3 = Të dhënat)

“**n**” është numri i ditëve në RLAH ($n \geq 30$) dhe

“**t**” është viti i aplikimit të parë të RLAH.

Kjo përqindje duhet të përdoret për të vlerësuar ndryshimin në vëllime gjatë periudhës së parashikuar 12-mujore duke e shumëzuar atë me vëllimet në vitin e kaluar.

- (1) Vlerat e Ponderuara w_k të shërbimeve mobile me pakicë:

$$w_k = \frac{\text{çmimi mesatar me shumicë i roamingut i paguar nga operatori}_{ki}}{\sum_{k=1}^3 \text{çmimi mesatar me shumicë i roamingut i paguar nga operatori}_k}$$

ku:

" k " = shërbimi (1 = zëri, 2 = SMS, 3 = Të dhënat)

"çmimi mesatar me shumicë i roamingut i paguar nga operatori" i referohet çmimit mesatar të njësisë për trafikun e pabalancuar të paguar nga operatori për secilin shërbim, ku njësia për secilin shërbim është € cent për (i) minutë të trafikut me zë; (ii) SMS për SMS; dhe (iii) MB për transferimin e të dhënave.

- (2) Raporti midis vëllimit të përgjithshëm të trafikut të shërbimeve roaming me pakicë të Aplikuesit dhe trafikut të përgjithshëm me pakicë (outbound) dhe me shumicë inbound për shërbimet e tij roaming:

$$\frac{\text{trafikun me pakicë "outbound" i roamingut}}{\text{trafikun i roamingut (me pakicë outbound + me shumicë inbound)}} = \sum_{k=1}^3 w_k \times \frac{\text{trafikun me pakicë "outbound" i roamingut}_k}{\text{trafikun i roamingut (me pakicë outbound + me shumicë inbound)}_k}$$

ku:

" k " = shërbimi (1 = zëri, 2 = SMS, 3 = Të dhënat)

- (3) Raporti i volumit të përgjithshëm të shërbimeve roaming me pakicë të Aplikuesit në BP dhe shërbime të tij të roamingut me pakicë në BP dhe në vendet e tjera:

$$\frac{\text{trafikun me pakicë outbound i roamingut në BP}}{\text{trafikun me pakicë outbound i roamingut (BP + Vendet tjera)}} = \sum_{k=1}^3 w_k \times \frac{\text{trafikun me pakicë outbound i roamingut në BP}_k}{\text{trafikun me pakicë outbound i roamingut (BP + Vendet tjera)}_k}$$

ku:

“k” = shërbimi (1 = zëri, 2 = SMS, 3 = Të dhënat)

- (4) Raporti i përgjithshëm i shërbimeve me pakicë të Aplikuesit brenda BP dhe trafikut të përgjithshëm me pakicë të të gjitha shërbimeve të tij mobile me pakicë:

$$\frac{\text{trafiku me pakicë outbound i roamingut në BP}}{\text{trafiku me pakicë outbound i roamingut}(BP + \text{Vendet tjera}) + \text{trafiku me pakicë i brendshëm}} \\ = \sum_{k=1}^3 w_k \times \frac{\text{trafiku me pakicë outbound i roamingut në BP}_k}{\text{trafiku me pakicë outbound i roamingut}(BP + \text{Vendet tjera})_k + \text{trafiku me pakicë i brendshëm}_k}$$

ku:

“k” = shërbimi (1 = zëri, 2 = SMS, 3 = Të dhënat)

- (5) Të hyrat nga trafiku me pakicë i roamingut në BP:

$$\begin{aligned} & \text{Të hyrat nga trafiku me pakicë në BP} \\ & = \text{të hyrat nga shërbimet me pakicë mobile} \\ & \times \left(\sum_{k=1}^3 w_k \times \frac{\text{trafiku me pakicë outbound i roamingut në BP}_k}{\text{trafiku me pakicë outbound i roamingut}(BP + \text{Vendet tjera})_k + \text{trafiku me pakicë i brendshëm}_k} \right) \end{aligned}$$

ku:

“k” = shërbimi (1 = zëri, 2 = SMS, 3 = Të dhënat).